



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 598/24 Dt. 01.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të faturës së papaguar të energjisë elektrike (rrymës) të krijuar (shpenzuar), në objektin i cili gjendet në Sheshin e Lidhjes Shqiptare në Prizren, kështu që, në emër të pagesës së faturës përkatëse (borxhit) të Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), përkatësisht për faturën e papaguar për njuhësorin me nr. DPZ [REDACTED] lejohen mjetet financiare në shumën prej 765.59 € (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e pesëdhjetë e nëntë cent).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe shpenzime komunale të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.



01 Nr. 599/24 Dt. 01.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të faturës të papaguar të energjisë elektrike (rrymës) të krijuar (shpenzuar), në objektin i cili gjendet në rr. "Adem Jashari" në Prizren, kështu që, në emër të pagesës së faturës përkatëse (borxhit) të Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), përkatësisht për faturën e papaguar për njuhësorin me nr. DPZ [REDACTED] lejohen mjetet financiare në shumën prej 758.30 € (shtatëqind e pesëdhjetë e tetë euro e tridhjetë cent).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe shpenzime komunale të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 594/24 Dt. 01.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e realizimit të projektit: “Inseminimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i lopëve, deleve dhe dhive kundër sëmundjeve infektive”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Kontrata do të jetë trevjeçare (kontratë kornizë).
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural- mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Beledije Başkanı

01 Nr. 597/24 Dt. 01.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, për lejimin e identifikimit dhe regjistrimit të pronave të paluajtshme të reja si dhe për verifikimin e pronave aktuale në Komunën e Prizrenit me qëllim të përmbushjes së objektivave rreth tatimit në pronë, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Komunës së Prizrenit–pozicioni mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Sektori i Prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



01 Nr. 610/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Kontratës për qiranë e tokës të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës 01 nr. 166/22 datës 29.09.2022, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejin e mjeteve

1. Lejohen mjetet financiare për pagesë të qirasë, e cila pagës është e bazuar në nenin 4 të Kontratës për qiranë e tokës të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës 01 nr. 166/22 datës 29.09.2022, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të pagesës së ratës së dytë dhe të tretë përkatësisht pagesës vjetore për vitin 2023 dhe 2024, lejohen mjetet financiare si në vijim:
 - 1.1. Për ratën e dytë lejohen mjete financiare në shumë prej 4.606.80 € (katër mijë e gjashtëqind e gjashtë euro e tetëdhjetë cent),
 - 1.2. Për ratën e tretë lejohen mjete financiare në shumë prej 4.606.80 € (katër mijë e gjashtëqind e gjashtë euro e tetëdhjetë cent).
 2. Shuma e përgjithshme që lejohet për pagesë të dy ratave të cekur si më lartë është në shumë prej 9.213.60 € (nëntë mijë e dyqind e trembëdhjetë euro e gjashtëdhjetë cent).
 3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Kontrata për qiranë e tokës e nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës 01 nr. 166/22 datës 29.09.2022.
 4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
 5. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinës dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinës dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - MBPZHR-Agjencia Pyjore e Kosovës,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





01 Nr. 609/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 40 të Ligjit nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, dispozitave të Rregullores për Shërbime Publike dhe Komunale në Komunën e Prizrenit 001/011-73507 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj akteve administrative të marra nga ana e Inspektoratit komunal të mbrojtjes së mjedisit, Inspektoratit komunal të ndërtimit dhe Inspektoratit komunal për shërbime publike (inspektorëve komunal) të Komunës së Prizrenit. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Fatmir Memaj,.....kryesues,
 - 1.2. Artan Gashi,.....anëtar,
 - 1.3. Afërdita Mormorina,.....anëtare.
 - Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me Ligjin 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Rregullores për Shërbime Publike dhe Komunale në Komunën e Prizrenit 001/011-73507 dhe ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
 - Mandati i Komisionit është 2 (dy) vjeçar me të drejtë vazhdimi.
 - Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet vendimi i kryetarit të Komunës 01 nr.577/24 i datës 23.09.2024.
 - Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
 - Obligohet Drejtoria e Inspektorateve si dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Inspektorateve,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit .

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





01 Nr. 608/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për pranimin teknik të punimeve në projektin: “Ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Vërmicë”. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Zana Belloda,..... ing. i dipl. i arkt. anëtare,
 - 1.2. Ejup Kryeziu,..... ing. i dipl. i ndërt., anëtar,
 - 1.3. Gëzim Gërgi,..... ing. i dipl. i elekt., anëtar.
2. Detyrat e Komisionit do të jenë: të verifikoj punimet e realizuara nga ana e OE “Top Projekt” shpk dhe të bëj pranimin teknik të punimeve të realizuar në projektin: “Ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Vërmicë” me nr. të kontratës 622-23-1622-5-2-1/C1101, aneks kontratës me nr. 622-24-9548-5-2-5/C1494 dhe konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 601/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Memorandunit të Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 418/24 datë 09.07.2024 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e mjeteve për bashkëfinancim

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit: “Ndërtimi i Stadiumit në fshatin Kabash-Has”, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 5 të Memorandunit të Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 418/24 datë 09.07.2024, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 249.350,00 € (dyqind e katërdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 418/24 datë 09.07.2024.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të bëhet nga kodi buxhetor, nr. 53618.
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - FFK-së,
 - Arkivës së Kryetarit.





01
Nr. 600/24 Dt. 01.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së dr. Shpresa Goçaj, radiologe në QKMF në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e dr. Shpresa Goçaj, radiologe në QKMF në Komunën e Prizrenit, për lejimin e udhëtimit zyrtar për pjesëmarrje në Kongresin European për Imazherinë dhe Diagnostikën e Sëmundjeve të Gjirit, që do të mbahet nga data 03 tetor 2024 deri me 05 tetor 2024, në Lisbonë të Portugalisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit, të akomodimit, pagesa e mëditjeve dhe shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurën, konform, akteve ligjore për Udhëtimet Zyrtare.
2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 01 tetor 2024 dhe kthimi me 06 tetor 2024.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurës,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 606/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Lejohet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit 01 nr. 542/24 të datës 05.09.2024, që ka të bëjë me formimin dhe emërimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj listës së përfituesve për pako ushqimore dhe higjienike të publikuara nga ana e Komisionit që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve) për persona fizik për furnizim me pako ushqimore dhe higjienike nga radhët e komunitetit minoritar në Komunën e Prizreni, kështu që, në vend të anëtares Senada Etemi, e emëruar si në pikën 1.3 të vendimit bazik, emërohet: Bashkim Rakaj.
2. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01 nr. 542/24 të datës 05.09.2024, mbesin të pandryshuara.
3. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim, Kryesuesi i Komisionit dhe të lartcekurit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
 - Kryesuesit të Komisionit,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 607/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Lejohet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit 01 nr. 543/24 të datës 05.09.2024, që ka të bëjë me formimin dhe emërimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj listës së përfituesve për dru të zjarrit për ngrohje të publikuara nga ana e Komisionit që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve) për persona fizik për furnizim me dru për ngrohje për familjet skamnore nga radhët e komunitetit minoritar në Komunën e Prizrenit, kështu që, në vend të anëtares Senada Etemi, e emëruar si në pikën 1.3 të vendimit bazik, emërohet: Bashkim Rakaj.
2. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01 nr. 543/24 të datës 05.09.2024, mbesin të pandryshuara.
3. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim, Kryesuesi i Komisionit dhe të lartcekurit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
 - Kryesuesit të Komisionit,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 614/24 Dt. 07.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Sindikatës së Policisë së Kosovës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Sindikatës së Policisë së Kosovës nr. 01-13-24 e datës 25.09.2024, për lejin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e lojërave tradicionale (sportive) në Prizren të cilat do të mbahen me datën 24, 25 dhe 26 tetor 2024, për nder të zyrtarëve policor të rënë në detyrë, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve për akomodimin e mysafirëve që marrin pjesë në këtë aktivitet dhe që janë përfaqësues të sindikatave të Policisë në rajon dhe më gjerë, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Mbulimi i shpenzimeve të akomodimit lejohet për datat e lartcekura në këtë vendim.
3. Mjetet e lartcekura do të lejohen pas parashtrimit të faturave përkatëse.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
5. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 623/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas shqyrtimit të kërkesës 01-030 nr. 132976 të datës 04.10.2024, të Shoqatës së Strip Artistëve “Xhennet Comics”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 132976 të datës 04.10.2024, të Shoqatës së Strip Artistëve “Xhennet Comics”, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth organizimit të Festivalit të 21 Ndërkombëtar të stripit dhe karikaturës që do të mbahet këtë vit në Prizren, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve rreth këtij festivali, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Shoqatës “Xhennet Comics”,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 629/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nenit 29 të Rregullores MF-nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin si dhe Doracaku i menaxhimit financiar dhe kontrollit (mfk) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

- Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Rregullës së Brendshme dhe Procedurës standarde të operimit për menaxhim të rrezikut në Komunën e Prizrenit. Për anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
 - 1.1. Haziz Krasniqi,Kryesues,
 - 1.2. Gjafer Ponik.....anëtar,
 - 1.3. Fejsal Hoti.....anëtar,
 - 1.4. Idaim Kryeziu.....anëtar,
 - 1.5. Marigona Ukaj.....anëtar,
 - 1.6. Veton Xhemaj.....anëtar,
 - 1.7. Haxhere Gavazaj.....anëtar.
- Detyra e kryesuesit të grupit punues dhe anëtarëve të grupit punues, në bashkërendim me NjAB, është që t'i hartoj këto dy dokumente konformë kërkesave ligjore të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Rregullores MF-nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Doracaku i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) dhe pas hartimit të draftit përkatës, ti procedohet organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi.
- Obligohet Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit Punues për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Të emëruarve,
 - NjAB
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 625/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, konform kërkesës së OE –“Bajram Ha Gashi BI”; OE “MBB Construction” shpk, të Menaxherit të Kontratës dhe Organit Mbikëqyrës, për lejin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Renovimi i objekteve të Administratës së Komunës së Prizrenit”, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 6.590,50 € (gjashtëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë euro e pesëdhjetë cent).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t'i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-24-2331-5-2-1, të datës 29.05.2024 me OE –“Bajram Ha. Gashi BI”, MBB Construction” shpk .
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i Drejtorisë së Administratës, nr. 48450.
4. Obligohet Drejtoria e Administratës , Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës * Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 624/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e realizimit të projektit: “Incizimi gjeodezik i infrastrukturës së rrugëve fushore, parcelave ku bëhet mbjellja e pemëve, hapja e puseve, kanaleve, stallave, sereve”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Kontrata do të jetë trevjeçare (kontratë kornizë).
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural- mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 626/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e furnizimit me katër (4) kabinete për kimi, fizik dhe biologji për nevojat e disa shkollave të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës -mallra dhe shërbime, nr. 13509.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës ,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 630/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nenit 29 të Rregullores MF-nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Doracaku i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e koordinatorit për menaxhim të rrezikut

1. Gjafer Ponik-Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Prizrenit, caktohet koordinator për menaxhimin e rrezikut në Komunën e Prizrenit.
2. Detyra dhe përgjegjësit e zyrtarit të caktuar në pikën 1 të këtij Vendimi janë të parapara në Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Rregulloren MF-nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Doracakun e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe akte tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi.
4. Obligohet zyrtari i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të lartcekurit,
 - Organeve tjera kompetente,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 617/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01 nr. 392/24 të datës 27. 06.2024, që ka të bëjë me lejin e mjeteve financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit: “Zhvillimi socio-ekonomik përmes turizmit kulturor dhe zgjerimit të hapësirave kulturore”, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit (bashkëfinancimit) të lidhur mes Komunës së Prizrenit, Fondacionit Allianz dhe Autostrada Biennale, 01 nr. 331/24, të datës 31.05.2024, kështu që, pika 4 e Vendimit bazike, ndryshohet dhe plotësohet dhe do të jetë:
2. Shuma e lejuar, me këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni investime kapitale, nr. 54679.
3. Pjesët tjera të Vendimit 01 nr. 392/24 të datës 27.06.2024, mbesin të pandryshuara.
4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Zyrtarit Monitorues të projektit,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 627/24 Dt. 10.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Lejohet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit 01/060-0063605/22 të datës 05.05.2022, për themelimin dhe emërimin e Komisionit Komunal për Kthim, kështu që, në vend të Idballka Fazlija Rama nga ZKK, e emëruar si në pikën 1.1 të vendimit bazik, emërohet: Derya Kala, Udhëheqëse e Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
2. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01/060-0063605/22 të datës 05.05.2022, mbesin të pandryshuara.
3. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim, dhe të lartcekurit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
 - Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 635/24 Dt. 14.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet ftesa e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, drejtuar kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, e bërë në emër të Byrosë Arsimore dhe Kulturore të Departamentit të Shtetit të ShBA, për pjesëmarrje në Forumin e Lidershit Global të Humphrey 2024, si folësi kryesor, që mbahen nga data 21 tetor 2024 deri me 25 tetor 2024 në Washington, D.C në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 18 tetor 2024 dhe kthimi me 27 tetor 2024, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit për dy (2) ditë të qëndrimit, ndërsa për ditët tjera të qëndrimit, organizatori i takimit do ti mbulojë shpenzimet e akomodimit, si dhe lejohen mjetet financiare për pagesë të mëditjeve si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurin, konform këtij vendimi dhe akteve ligjore për Udhëtimet Zyrtare.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Kabinetit të Kryetarit,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 644/24 Dt. 16.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në ftesën e Organizatës Ndërkombëtare "Promo Global" me seli në Zagreb të Republikës së Kroacisë, për lejin e udhëtimit zyrtar të Rasim Demirit, Bashkim Rakaj dhe Defrim Zajmi, për në Podgoricë dhe Budvë të Republikës së Malit të Zi, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën Ndërkombëtare "The Word Congress of Enterpreneus" që do të mbahet nga data 16 tetor 2024 deri me 19 tetor 2024, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të transportit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 645/24 Dt. 17.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e transportit të punëtorëve udhëtar të Administratës-shërbyesve civil, që punojnë në administratën komunale të Komunës së Prizrenit, të cilët udhëtojnë në vendet e punës (vajtje-ardhje në punë), kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor-mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Administratës dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 642/24 Dt. 17.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, për lejin e fillimit të procedurave për ofrimin e Shërbimeve konsulentë nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta për nevojat e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, me qëllim të digjitalizimit të arkivës përkatësisht identifikimin e lëndëve që kanë të bëjnë me pagesë të përfunduara në të gjitha drejtoritë e Komunës, skanimi i lëndëve, futja në sistemin digjital dhe arkivimi i tyre, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse, për angazhim (pranim) e 3 (tre) konsulentëve për periudhë prej 2 (dy) vite .
2. Ky Vendim realizohet financiarisht nga buxheti i Komunës së Prizrenit-kodi buxhetor mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Sektori i Prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 644/24 Dt. 17.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e realizimit të projektit: “Renovimi i pjesërishëm i kulmit të objektit shkollor “Luigj Gurakuqi” në Nashec-Prizren”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës–pozicioni mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



01 Nr. 643/24 Dt. 17.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b dhe g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 12 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet e Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), në fushën e kulturës në Komunën e Prizrenit

1

1.1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

1.2. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohen nga Buxheti i Komunës së Prizrenit, kodi ekonomik subvencione në shumën prej 20.000.00 € (njëzetmijë euro).

2

Mjetet e përmendura në nenin 1.2. të këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe dispozitave të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

3

Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 649/24 Dt. 18.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ramize Shala-drejtoresh e DES, për pjesëmarrje në punëtorinë për Mbrotjtje Civile, që do të zhvillohet nga data 20 tetor 2024 deri me 23 tetor 2024 në Rijekë të Republikës së Kroacisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të transportit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurën.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurës,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



01 Nr. 651/24 Dt. 22.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 40 të Ligjit nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, nenit 6 të Rregullores (QRK) nr. 25/2024 për Rregullat e Përbërjes së Organit Kolegjial për Procedurën e Shqyrtimit të Ankesës Administrative ndaj Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, dispozitave të Rregullores për Shërbime Publike dhe Komunale në Komunën e Prizrenit 001/011-73507 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin dhe përbërjen e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në rastin e inspektorateve komunale

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj akteve administrative të marra nga ana e Inspektoratit komunal të mbrojtjes së mjedisit, Inspektoratit komunal të ndërtimit dhe Inspektoratit komunal për shërbime publike (inspektorëve komunal) të Komunës së Prizrenit. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - Arben Krasniqi,.....kryesues,
 - Artan Gashi,.....anëtar,
 - Afërdita Mormorina,.....anëtare.
 - Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me Ligjin 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Rregullores për Shërbime Publike dhe Komunale në Komunën e Prizrenit 001/011-73507 dhe ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
 - Konform nenit 6 paragrafi 4, i Rregullores (QRK) nr. 25/2024 për Rregullat e Përbërjes së Organit Kolegjial për Procedurën e Shqyrtimit të Ankesës Administrative ndaj Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, mandati i Komisionit është 3 (tre) vjeçar.
 - Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet vendimi i kryetarit të Komunës 01 nr. 609/24 i datës 02.10.2024.
 - Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
 - Obligohet Drejtoria e Inspektorateve si dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Inspektorateve,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit .

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





01 Nr. 656/24 Dt. 24.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejin e pastrimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të KK-Prizren dhe QKMF-së, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Administratës dhe drejtorive tjera komunale -mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 660/24 Dt. 24.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të krijuara rreth pritjes zyrtare të delegacionit nga Qyteti i Bursës-Komuna Orhangazi e Republikës së Turqisë, të cilët do ta vizitojnë Komunën e Prizrenit nga data 25 tetor 2024 deri me 27 tetor 2024, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të akomodimit, ushqimit, dhe shpenzimeve tjera të paparashikuara, rreth pritjes së këtij delegacioni, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Qëllimi i vizitës zyrtare të këtij delegacioni është fillimi i bashkëpunimit mes të Komunës së Prizrenit dhe Komunës Orhangazi në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit, etj.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jenë faturat përkatëse.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Zyrës së Kryetarit,
 - Arkivës së Kryetarit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 655/24 Dt. 24.10.2024



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

- Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve të cilët kanë aplikuar në projektin: “Ngritja e pemishtes me pemë arrore” me bashkëfinancim. Anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:
 - Shaban Krasniqi,.....kryesues,
 - Jakup Kastrati,anëtar,
 - Njazim Mustafi,.....anëtar.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha aplikacionet e fermerëve të cilët kanë aplikuar në projektin: “Ngritja e pemishtes me pemë arrore” me bashkëfinancim, konform thirrjes publike për aplikim, nr. 10-320-130391 të datës 27.09.2024. Komisioni pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të përshkruar si në pikën 1 dhe 2 të këtij Vendimi, të vendos dhe përcaktoj fituesit e thirrjes publike.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Të emëruarve,
 - Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





01 Nr. 657/21 Dt. 24.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e furnizimit me 2 (dy) tabela të menqura, 8 (tetë) kompjuter dhe 1 (një) laptop për nevojat e Shkollës së Mesme të Lartë të Muzikës “Lorenc Antoni” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhje e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet nga buxheti vetanak i Shkollës së Mesme të Lartë të Muzikës “Lorenc Antoni” -mallra dhe shërbime, nr. 13503, 13504, 13509.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, ShMLM “Lorenc Antoni”, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - ShMLM “Lorenc Antoni”,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.



01 Nr. 658/24 Dt. 24.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu” në Prizren, për lejimin e mjeteve financiare për pagesën (honorarët) për të angazhuarit e jashtëm për shfaqjen teatrale “Ping Pong dhe Dashuri”, të autorit dhe regjisorit Butrint Paha, kështu që, në emër të pagesës së angazhimit, lejohen mjetet e nevojshme financiare për secilin prej të angazhuarave të jashtëm si në vijim për:
 - 1.1. Butrint Pasha-autor dhe regjisor, lejohen mjetet në shumën prej 4500 € (katërmijë e pesëqind euro),
 - 1.2. Adhurim Grezda-kompozitor, lejohen mjetet në shumën prej 2.000 € (dymijë euro),
 - 1.3. Blin Mani, aktor i jashtëm, lejohen mjetet në shumën prej 2.880 € (dymijë e tetëqind e tetëdhjetë euro),
 - 1.4. Doruntina Basha, konsulentë e dramaturgisë, lejohen mjetet në shumën prej 600 (gjashtëqind euro),
 - 1.5. Petrit Bakalli-stenograf dhe realizues i stenografisë, lejohen mjetet në shumën prej 3.500 € (tremijë e pesëqind euro),
 - 1.6. Alma Krasniqi, kostumografe dhe realizuese e kostumeve, lejohen mjetet në shumën prej 3.000 € (tremijë euro),
 - 1.7. Skender Latifi –dizajner i ndriçimit, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),
 - 1.8. Gëzim Sertollaj-koreograf i ushtrimeve plastike, lejohen mjetet në shumën prej 1.130 € (njëmijë e njëqind e tridhjetë euro),
 - 1.9. Ender Shaljani-xhirues dhe fotograf i shfaqjes, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),
 - 1.10. Arshi Shaljani-dizajner grafik, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),
 - 1.11. Canan Güner-grimere, lejohen mjetet në shumën prej 980 € (nëntëqind e tetëdhjetë euro).
 2. Shuma e përgjithshme që lejohet është 20.990 € (njëzetmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë euro).
 3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohen nga buxheti i Komunës pozicioni i subvencioneve dhe transfereve -kodi nga Teatri i Qytetit (nr. 85157).
 4. Obligohet Teatri i Qytetit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Teatrit të Qytetit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 659/24 Dt. 24.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Teatrit të Qytetit "Bekim Fehmiu" në Prizren, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Burim Mustafa -drejtor i Teatrit të Qytetit "Bekim Fehmiu" në Prizren, për pjesëmarrje në Edicionin Kosovo Albanian Showcase, që do të zhvillohet nga data 29 tetor 2024 deri me 02 nëntor 2024 në Tiranë të Republikës së Shqipërisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të transportit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Teatri i Qytetit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Teatrit të Qytetit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 666/24 Dt. 28.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për pranimin teknik të punimeve në projektin: “Rregullimi i kabinetit për realizimin e praktikës profesionale për profilin: Teknik Dentar në SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Durim Ramadani,..... mr. i farmacisë,
 - 1.2. Jusuf Kelmendi,.....prof. i kimisë.
 - 1.3. Sabit Hajdari,.....prof i matematikës.
- Detyrat e Komisionit do të jenë: të verifikoj punimet e realizuara nga ana e OE “Triangles shpk” nga Suhareka dhe të bëjë pranimin teknik të punimeve të realizuar në projektin: “Rregullimi i kabinetit për realizimin e praktikës profesionale për profilin: Teknik Dentar në SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren me nr. të kontratës 622-24-8354-5-2-1/C1506, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

